



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KUVENDI I KOMUNËS NË KLINË

RREGULLORE PËR PUNËN E KUVENDIT DHE KOMITETEVE TË KOMUNËS

Klinë, maj 2011

Duke iu referuar dispozitave ligjore dhe mandatit të dhënë nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, i dt. 20 shkurt 2008, dhe atë nenit 12 pika 12.2 nenë (b) dhe 12.4, pastaj dispozitës së nenit 10 al. 2 pika 2 të Statutit të Komunës së Klinës, me qëllim të mbarëvajtjes së përgjithshme dhe rregullimit të punës së Kuvendit të Komunës, pastaj Komiteteve, si dhe rendin dhe procedurën për mbajtjen e mbledhjeve të tyre, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të V-të me radhë për vitin 2011, mbajtur, më 27 maj 2011, nxori dhe miratoi, këtë:

RREGULLORE

Për

PUNËN E KUVENDIT DHE TË KOMITETEVE TË KOMUNËS

I.- DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Më këtë Rregullore përcaktohet: mënyra, udhëheqja dhe funksionimi i punës së Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve.

Përkufizimet

Neni 2

Përkufizimet në këtë Rregullore:

- a. “Ligj”, nënkupton Ligjin nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisjen Lokale;
- b. “Statut”, nënkupton aktin më të lartë juridik të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Klinës;
- c. “Komitet”, nënkupton komitetet e përhershme dhe komitetet tjera, të themeluara nga Kuvendi i Komunës në pajtim me Ligj, Statutin e Komunës dhe Rregulloren për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve;
- d. “Anëtar i Kuvendit”, nënkupton anëtarin e Kuvendit, të zgjedhur drejtpërdrejt nga vota e qytetarit, në pajtim me ligjin në fuqi për zgjedhjet lokale;
- e. “Kryetar i Komunës”, nënkupton kryetarin e zgjedhur drejtpërdrejt nga votuesit që kanë të drejtë vote në komunë, në përputhje me ligjin në fuqi për zgjedhjet lokale;
- f. “Kryesues i Kuvendit”, nënkupton kryesuesin e zgjedhur nga anëtarët e Kuvendit të Komunës;
- g. „Kryesuesi i Komitetit,” , nënkupton kryesuesin e zgjedhur nga anëtarët e Komitetit;
- h. “Këshilli i drejtorëve”, nënkupton drejtorët e emëruar nga Kryetari i Komunës;
- i. “Drejtor”, nënkupton të emëruarin politik për mandat të njëjtë me Kryetarin e Komunës, i cili drejton një drejtori të caktuar.

PJESA E I-rë: KUVENDI I KOMUNËS

Neni 3

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet lokale.

Kandidimi, mandati, për anëtarë të Kuvendit, si dhe deklarata solemne, përmbajtja dhe nënshkrimi i saj (neni 35. pika 35.4 të LVL-e), rregullohen më për së afërmi me nenin 35 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Ligjin për Zgjedhjet lokale.

Kuvendi i Komunës së Klinës ka gjithsej 27 anëtarë, dhe ai është proporcional me numrin e qytetarëve në komunë, dhe në pajtueshmëri me dispozitën e nenit 36 të LVL-e.

Mandati i anëtarëve të Kuvendit është 4 vjet.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, thirrja-konvokimi, numri i tyre dhe njoftimi i mbajtjes së tyre

Neni 4

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës (neni 43 i LVL-së).

Kryesuesit e Komiteteve thërresin dhe kryesojnë mbledhjet e komiteteve përkatëse.

Neni 5

Kuvendi i Komunës mban së pakut 10 (dhjetë) seanca në vit, 5 (pesë) prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit dhe 5 (pesë) të tjera në pjesën e dytë të vitit, siç përcaktohet më këtë Rregullore.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) Datën e mbajtjes së mbledhjes,
- b) Kohën e mbajtjes së mbledhjes,
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes,
- d) Rendin e ditës së mbledhjes,
- e) Materialet e mbledhjes, si dhe
- f) Të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut, ose me Rregulloren e punës.

Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe Rregulloren komunale për gjuhët në përdorim zyrtar në komunë.

Njoftimi duhet t'i shpallet publikut (neni 43 pika 43.4 i LVL-e), ndërkaq që ai bëhet edhe përmes Tabelës së shpalljeve të Komunës, pastaj web-faqes komunale, apo edhe mediet e tjera të shkruara elektronike lokale, përmes Zyrës komunale për informim.

Njoftimi, po ashtu duhet t'i dërgohet MAPL-së në Prishtinë.

Takimet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

Neni 6

Takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit të Komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga më së paku një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, apo më kërkesë të Kryetarit (neni 44 i LVL-e).

E drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm, gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.

Pikat e caktuara në rëndin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes (neni 44 pika 44.3 i LVL-e).

Takimi i jashtëzakonshëm nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe publiku nuk janë njoftuar më shkrim, siç kërkohet me Rregulloren e punës, së pakut 3 ditë pune para datës së mbajtjes së takimit.

Procedurat e njëjta që kërkohen për njoftimin dhe çështjet e tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme gjithashtu.

Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

Neni 7

Njoftimi dhe shpallja për takimin e jashtëzakonshëm ka përmbajtjen si nga alineja 4 e nenit 6 të kësaj Rregulloreje.

Takimet e hapura

Neni 8

Takimet e hapura të Kuvendit të Komunës si dhe të komisioneve të tij janë të rregulluara me dispozitën e nenit 45 të LVL-e, si dhe me Rregulloren tjetër komunale që rregullon konsultimin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje apo transparencën.

Seancat e mbyllura

Neni 9

Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe seanca të mbyllura në pajtim me nenin 45 pika 45.5 të LVL-e.

Kuorumi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij

Neni 10

Kuorumi duhet të vërtetohet para çdo vendimi të miratuar.

Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, përbëhet nga më tepër se gjysma e anëtarëve, përveç rasteve kur për votim nevojiten 2/3 e anëtarëve të Kuvendit. Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe propozimet e komiteteve, merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm të cilët votojnë, nëse me Ligj dhe Statut nuk është paraparë ndryshe.

PJESA E II-të: KOMITETET E KUVENDIT

Struktura dhe komitetet e Kuvendit

a) Komitetet e Përhershme

Neni 11

Komitetet e përhershme që i themelon Kuvendi i Komunës janë: Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti i Komuniteteve.

Struktura dhe numri i tyre janë të përcaktuara nga neni 31 deri ne nenin 36 të Statutit.

Neni 12

Kuvendi i Komunës për përmbushjen e përgjegjësive të veta ngrit dhe themelon trupa punuese të përhershme si nga neni 13 al. 1 i kësaj Rregulloreje po edhe trupa të tjerë-komitete të tjera dhe komitete konsultative, por mund të ngrit edhe komisione ad hoc mandati i të cilave përfundon me zgjidhjen e çështjes konkrete.

b) Komitetet tjera të Kuvendit të Komunës

Neni 13

Komitetet tjera janë:

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
2. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
3. Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
4. Komiteti për Shërbime Publike,
5. Komiteti për Pronë.

Për themelimin e secilit komitet duhet të votohet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në Kuvendin e Komunës.

Përshkrimi i përgjegjësive dhe detyrave të këtyre komiteteve si dhe përbërja dhe kompetencat bëhet me rregullativë të veçantë.

c) Komitetet Konsultative të Kuvendit të Komunës

Neni 14

Komitetet Konsultative janë komitete profesionale, të cilat themelohen në kuptim të nenit 73 të LVL-e.

Komitetet Konsultative themelohen nga Kuvendi i Komunës, pas propozimit të marrë nga Kryetari i Komunës, nga komitetet e përhershme dhe nga grupi i qytetarëve.

Anëtarësimi në Komitete Konsultative bëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, të cilët njëherësh duhet të jenë njohës dhe profesionistë të mirë të lëmive përkatëse.

Mënyra e zgjedhjes dhe themelimit të këtyre komiteteve bëhet sipas konkursit publik të Kuvendit të Komunës, në të cilin përcaktohen kriteret dhe kushtet e konkurrimit.

Kandidatët për anëtarë të komiteteteve duhet të jenë banorë të Komunës së Klinës.

Kuvendi i Komunës ngrit Komisionin për intervistimin e kandidatëve, i cili në përbërje duhet të ketë anëtarë të Kuvendit dhe të Shoqërisë civile.

Komisioni i propozon Kuvendit të Komunës listën e kandidatëve për Komitetet Konsultative.

Listën e kandidatëve e miraton Kuvendi.

PJESA E III-të: KONVOKIMI DHE KRYESIMI I MBLEDHJEVE TË KOMITETEVE TË KUVENDIT

Neni 15

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës është Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesit e Komiteteve tjera duhet të konvokojnë dhe kryesojnë mbledhjet e komiteteve përkatëse.

Kryesuesi i Komitetit mund të konvokojë në çdo kohë, kur paraqitet nevoja, mbledhjet e jashtëzakonshme të komitetit.

Numri i anëtarëve, i cili njëherësh përbën kuorumin e Komitetit në çdo kohë, kur paraqitet nevoja mund të thërras mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme.

Neni 16

Në mungesë të Kryesuesit, ose kur ata nuk janë në gjendje të punojnë, zëvendësit e tyre do të konvokojnë dhe kryesojnë mbledhjet.

Nëse edhe zëvendësi mungon, ose nuk është në gjendje të punojë, mbledhja do të konvokohet dhe kryesohet nga anëtari më i moshuar i pranishëm.

Çështjet tjera lidhur me komitetet e përhershme janë të rregulluara edhe me dispozitat e nenit 52 dhe 53 të LVL-e.

Procedimi në mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Rendi i ditës

Neni 17

Rendi i ditës për takimin e Kuvendit të Komunës caktohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në marrëveshje me Kryetarin e Komunës (neni 47 i LVL-e), apo në mungesë të Kryetarit, në marrëveshje me Nënkryetarin.

Anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pike në rëndin e ditës gjatë seancës së rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend dite është çështje urgjente më rëndësi publike.

Kërkesa e tillë mund të miratohet, apo refuzohet me votën e shumicës.

Neni 18

Rendin e ditës për çdo mbledhje të Kuvendit të Komunës, me materialin përkatës të nevojshëm, e përgatit shefi i Shërbimit për Punë të Kuvendit me marrëveshje paraprake me Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit, apo edhe Zëvendëskryesuesin, nëse ky ekziston.

Të gjitha përgatitjet e rregullta teknike, të mbledhjeve dhe të materialit për to, brenda afatit përkatës i bën Shërbimi për Punë të Kuvendit.

Neni 19

Në mbledhje mund të vendoset që të punohet edhe me rend të ditës të ndryshuar.

Kur rendi i ditës ishte shpërndarë anëtarëve të Kuvendit të Komunës, Shërbimi për Punë të Kuvendit, duhet:

- t'i dërgojë secilit anëtar një kopje të dokumentit të Komunës, i cili përmban shënime lidhur me çështjet që do të shtrohen në mbledhje;

- t'i njoftojë anëtarët se dokumenti është i gatshëm për shqyrtim dhe ta bëjë atë dokument të gatshëm për përdorim nga anëtarët gjatë orëve të rregullta të punës në zyrën përkatëse.

E drejta e shqyrtimit nuk vlen për të gjitha dokumentet për të cilat përjashtohet publiku nga e tërë apo një pjesë e mbledhjes.

Neni 20

Personat kompetentë, nga alineja 1 e nenit 17 mund të konsultohen me shefat e Grupeve të anëtarëve para caktimit të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Rendi i ditës përmban:

1. Arsyetimin e mungesave nga mbledhja e kaluar, apo kërkim falja për mospjesëmarrje,
2. Delegimi, apo pjesëmarrja e publikut,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
4. Peticionet dhe shkrimet eventuale për të cilat mbledhja është paraparë t'i tubojë,
5. Caktimi dhe trajtimi i çështjeve sipas pikave të rendit të ditës konform dispozitave të Statutit si dhe të LVL-e,
6. Çfarëdo çështje e shtruar nga Kryesuesi për temat që lindin aty për aty, apo punët e papërfunduara nga mbledhja e kaluar,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt akteve nënligjore apo propozim-vendimeve përkatëse,
8. Raportet dhe rekomandimet e Kryetarit të Komunës dhe të udhëheqësve të tjerë të Ekzekutivit të Komunës,
9. Aktivitetet e Komunës sipas rendit të ditës, apo të parashtruara nga anëtarët,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i preferencave të KPF-së dhe raporteve dhe rekomandimeve të komiteteve të tjera,
11. Shqyrtimi i kërkesave të paraqitura Kuvendit,

12. Të ndryshme: çështje të ndryshme për të cilat Kryetari, apo Kryesuesi mendon se janë më rëndësi të shqyrtohen.

Neni 21

Rendi i ditës pas shqyrtimit dhe vënies për miratim, miratohet me votë të hapët - ngritje dore me shumicë votash të anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.

Para miratimit të rendit të ditës, në mbledhje mund të propozohet ndryshimi apo plotësimi i rendit të ditës, i cili propozim vihet në vota nga Kryesuesi dhe mund të vendoset me votë të hapët-ngritje dore me shumicë votash të anëtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.

Shpërndarja e materialit shtesë për mbledhje

Neni 22

Çdo anëtar i Kuvendit të Komunës në afatin e paraparë nga neni 7 al. 3 të kësaj Rregulloreje, bashkë më ftesën për mbledhje i dërgohet edhe materiali sipas pikave të rendit të ditës.

Nëse prej ditës së dërgimit të materialit e deri në ditën e mbajtjes së mbledhjes, sipas nevojës urgjente është paraqitur ndonjë raport apo propozim, atëherë Shefi i Shërbimit për Punë të Kuvendit, në mbledhje anëtarëve ua shpërndan materialin përkatës.

Nëse materiali është unikat, atëherë secili anëtar i Kuvendit gjatë ditëve të punës ka të drejtë ta shikojë materialin e tillë edhe tek drejtoritë tjera.

Rregullat e debatit

Neni 23

Nuk mund të diskutohet asnjë pikë para se të shtrohet si propozim për diskutim në mbledhje.

Kur bëhen ndryshime, propozimi i ndryshuar zë vendin e propozimit të parë dhe shndërrohet në propozim të rregullt, në të cilin mund të propozohen ndryshime të tjera.

Nëse dy ose më shumë anëtarë dëshirojnë të marrin fjalën, kryesuesi i mbledhjes vendos për renditjen e diskutimit. Anëtarët i drejtohen kryesuesit të mbledhjes dhe gjatë diskutimit të tyre duhet t'u përmbahen çështjeve të diskutuara në mbledhje. Kryetarëve të grupeve parlamentare u jepet përparësi gjatë diskutimit. Për renditjen e kryetarëve të grupeve që kanë kërkuar fjalën, vendoset sipas numrit të anëtarëve që kanë grupet parlamentare në Kuvend.

Anëtarët mund të kërkojnë ta marrë fjalën sipas renditjes, ose sipas shpjegimeve personale, dhe diskutimi i tyre duhet të dëgjohet. Vendimi i kryesuesit mbi pikat e renditura, ose mbi pranimin e shpjegimeve personale, është vendimtar.

Kryesuesi në mbledhje nuk lejon asnjë propozim, derisa të gjithë ata që dëshirojnë të diskutojnë ta kenë bërë këtë për kohë të mjaftueshme.

Kur një propozim i dhënë është duke u diskutuar, nuk lejohet dhënia e propozimeve të tjera, përveç:

- a. ndryshimeve;
- b. propozimit të dhënë për të parandaluar çrregullimet;
- c. propozimit për të përjashtuar publikun dhe mjetet e informimit;
- d. propozimit për të kaluar në pikën me radhë të rendit të ditës;

e. propozimit i cili kërkon që çështja në diskutim të mbyllet në mbledhje me marrjen e vendimit;

f. propozimit për të shtyrë diskutimin e çështjes së shtruar për mbledhjen e radhës;

g. propozimit për ndërprerjen e mbledhjes.

Kur ndonjë anëtar e merr fjalën në mbledhje, të gjithë anëtarët tjerë pjesëmarrës qëndrojnë ulur. Nëse ndonjë anëtar jep ndonjë propozim, ai ka të drejtë të marrë përgjigjen menjëherë, para se propozimi t'i nënshtrohet votimit.

Gjatë kohëzgjatjes së mbledhjes, Kryesuesi duhet të respektojë parimin që të gjithë anëtarët pjesëmarrës me të drejtë diskutimi, të gëzojnë të drejtën e barabartë dhe të kenë rastin që të marrin pjesë aktivisht në mbledhje. Kryetarëve të grupeve parlamentare u lejohet që për një çështje që debatohet, të diskutojnë deri në 10 min, ndërsa për çështjet që konsiderohen më të rëndësishme vendoset nga Kuvendi. Anëtarëve të Kuvendit u lejohet të diskutojnë deri në 5 min. për çështjen që diskutohet. Nëse në diskutimin paraprak përmendet me emër ndonjë anëtar i Kuvendit, ai ka të drejtë të replikojë, por jo në kohëzgjatje më shumë se dy minuta.

Interpelanca

Neni 24

Një grup parlamentar, mund të parashtojë kërkesë për interpelancë për të shqyrtuar një çështje që ka të bëjë me punën e Qeverisë komunale, apo edhe të ndonjë drejtorie përkatëse.

Mocioni-kërkesa për interpelancë parashtrohet në formë të shkruar dhe përmban:

- formulimin e saktë të çështjes që është lëndë e interpelancës;

- arsyetimin për mocionin;

- emrin e mbiemrin dhe nënshkrimin e autorizuar nga grupi parlamentar përkatës.

Interpelanca mund të zgjasë maksimalisht 15 minuta.

Debati lidhur me interpelancën nuk mund të vazhdojë në seancën e ardhshme të Kuvendit.

Interpelanca për të njëjtën çështje nuk mund të parashtrohet më shumë se dy herë gjatë një viti buxhetor.

Votimi

Neni 25

Votimi në të gjitha mbledhjet bëhet me ngritjen e dorës, nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.

Para votimit, secili anëtar ka të drejtë të kërkojë që rezultatet e votimit të regjistrohen, ku do të shihen emrat e të gjithë anëtarëve që kanë votuar dhe emrat e atyre që abstenojnë.

Secili anëtar mund të kërkojë që në procesverbalin e mbledhjes të shënojë se si ai/ajo ka votuar për çështjen e caktuar, ose nëse ai/ajo ka abstenuar.

Kur ka nevojë të bëhet votimi i propozimit për zgjedhjen e ndonjë anëtari për pozitën e cila duhet të mbulohet nga Komuna, dhe kur ekzistojnë dy ose më shumë kandidatë të propozuar për pozitën në fjalë, emrat e të gjithë të propozuarve paraqiten në mbledhje sipas ranglistës së panelit intervistues, nëse është paraparë paneli, ose sipas radhitjes alfabetike të emrave të tyre.

Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe të komiteteve të tij, secili anëtar ka nga një votë. Kryesuesi ka votë shtesë, në rast të numrit të njëjtë të votave „për„ ose „kundër„, ndonjë propozimi.

Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm të cilët votojnë, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligj, Statut dhe Rregulloren e punës.

Në rast të votimit të fshehtë, zyrtarët e Drejtorisë së Administratës iu shpërndan fletëvotimet të gjithë anëtarëve me të drejtë vote, të cilat përmbajnë emrat e të gjithë kandidatëve të renditur sipas radhës alfabetike, duke u bazuar në mbiemrat e tyre. Shërbimi për Punë të Kuvendit duhet të sigurojë kutinë për votim, e cila duhet të jetë e gatshme për përdorim në mbledhje. Votimi bëhet menjëherë, duke shënuar “X” afër emrit të kandidatit, të cilin anëtari dëshiron ta votojë, dhe duke e hedhur fletëvotimin në kutinë e votimit. Abstenimet regjistrohen nëse në kutinë e votimit hidhet fletëvotimi i paplotësuar.

Komisioni për mbarëvajtje të votimit i numëron votat publikisht në mbledhje, menjëherë pas mbylljes së votimit, dhe deklaroi rezultatet pas përfundimit të numërimit të votave. Ai duhet t’i mbajë fletëvotimet në vend të sigurisë për së paku dymbëdhjetë muaj.

Kodi i mirësjelljes

Neni 26

Nëse kryesuesi i mbledhjes konsideron se ndonjëri prej anëtarëve nuk sillet mirë në mbledhje, duke mos respektuar fjalën e kryesuesit, duke e penguar me dashje punën e mbledhjes, ose duke u bërë sjellje ofenduese, atij duhet t’i tërhiqet vërejtja. Nëse sjelljet e anëtarit në fjalë vazhdojnë të jenë të pandryshueshme, kryesuesi i mbledhjes mund të ndërmarrë njërën prej këtyre masave, veçmas ose si varg masash:

- a. iu propozon të pranishmëve në mbledhje që anëtari të mos dëgjohet, në të cilin rast propozimi duhet të bëhet menjëherë në mbledhje, pa nevojë për kraheje dhe nëse propozimi miratohet, anëtarit i ndalohet diskutimi i mëtutjeshëm në mbledhje;
- b. e udhëzon anëtarin e Kuvendit/komitetit, të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga pjesa e mbetur e mbledhjes, përveç kur do të ketë votime;
- c. jep urdhrin që anëtari të largohet nga mbledhja, përveç kur do të ketë votime;
- d. e shtyn mbledhjen për një orë, ose deri në kohën, datën dhe vendin i cili mund të caktohet më vonë.

Nëse pjesëtari i publikut me dashje ndërpret punët e mbledhjes, kryesuesi i mbledhjes ia tërheqë vërejtjen atij/asaj. Nëse ai/ajo vazhdon ta ndërpres mbledhjen, kryesuesi i mbledhjes mund të ndërmarrë njërën prej këtyre masave, veçmas ose si varg masash:

- a. e udhëzon anëtarin të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga mbledhja;
- b. jep urdhrin që anëtari të largohet nga mbledhja;
- c. e shtyn mbledhjen për një orë, ose deri në kohën, datën dhe vendin i cili mund të caktohet më vonë.

Nëse mbledhja ndërpritet për ndonjë çrregullim, Kryesuesi i mbledhjes mund të urdhërojë që të gjithë të lirojnë sallën e mbledhjes dhe mund ta shtyjë mbledhjen për një orë, ose deri në kohën, datën dhe vendin i cili mund të caktohet më vonë.

Kompensimi i anëtarëve të Kuvendit, Komiteteve dhe stafit tjetër politik

Neni 27

Të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të Komiteteve të Kuvendit gjatë mandatit të tyre për punën që bëjnë si anëtarë të Kuvendit të Komunës, Komitetit apo stafit tjetër politik në komunë, kanë të drejtë kompensimi në pajtim me Statutin e Komunës, pastaj Udhëzimin përkatës administrativ të Ministrisë kompetente për pagesën e stafit politik në komuna.

Caktimi i kompensimit bëhet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës e në harmoni me aktet nga al.1 e këtij neni.

Procedura e ndryshimit

Neni 28

Procedura e ndryshimit të Rregullores së punës duhet të jetë siç vijon:

a. Çdo propozim për ndryshimin e Rregullores së punës duhet të miratohet nga Komiteti për Politikë dhe Financa;

b. Propozimi pastaj duhet t'i paraqitet Kuvendit të Komunës për shqyrtimin preliminar. Nëse propozimi nuk refuzohet nga Kuvendi, Kuvendi do të ndërmarr konsultime të hapura në lidhje me propozimin, siç është paraparë me Statut.

c. Pas përfundimit të periudhës së konsultimeve të hapura, Kuvendi i Komunës do të vendosë nëse do ta miratojë ndryshimin, me ose pa modifikime, pas shqyrtimit të të gjitha prezantimeve që janë pranuar.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 29

Në rast të kolizionit të dispozitave të kësaj rregulloreje me LVL-e apo akteve të tjera të Pushtetit qendror, si dhe në raste të zbrastërës tjetër juridike, në këtë Rregullore, drejtpërsëdrejti vlejné dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 i dt. 20 shkurt 2008, apo edhe dispozitat e akteve të tjera të Pushtetit qendror dhe ministrive kompetente.

Neni 30

Interpretimin autentik të dispozitave të kësaj Rregulloreje, e bën Kuvendi i Komunës.

Neni 31

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit të saj.

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës nr. 01-110-5016/08 e dt. 05.11.2008.

Nr.01-110-1653/2011

Klinë, më dt. 27.05.2011.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË



Kryesuesi,
Fadil Gashi